

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mbi 3100 pasuri të sekuestruara në administrim, rriten të ardhurat dhe ripërdorimi social
ADRESA	https://a2news.com/shqiperia/kronike/mbi-3100-pasuri-te-sekuestruara-ne-administrim-rrit-en-te-ardhu-i1185031
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 13:17:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 13:12:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8ebb07c1295e535474326db895805926cb45a717f439bd0a1e333baf3ae10b87
TEKSTI	7b9e8f5e695fa1fe0958984623ad92a6161f119d47b14bc597f97fc34c6c4613
PAMJA	aa243dc4adeefdcafad81ce774589e98255164553e64708303b1b2a237dbf928

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	24afad3d6ad128f3b52b63223ec29aea9030581f45af7bcaf883b444486fd492
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0b6439cf09af002acf6ffba878872d12e4fabe601bb852ed9a98adac17b7c4e3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/24afad3d6ad128f3b52b63223ec29aea9030581f45af7bcaf883b444486fd492>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbi 3100 pasuri të sekuestruara në administrim, rriten të ardhurat dhe ripërdorimi social

Nga A2 CNN
14 Shtator 2026, 15:12 | Kronikë



Kryeadministratorja e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), Risena Xhaja, raportoi sot në Komisionin për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale të Kuvendit të Shqipërisë, mbi rezultatet e veprimtarisë së Agjencisë, administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, ripërdorimin social, bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, si dhe prioritetet në kuadër të procesit të integrimit evropian.

Gjatë raportimit u evidentua transformimi i AAPSK-së drejt një modeli më aktiv, transparent dhe produktiv të administrimit të pasurive, me synim ruajtjen dhe rritjen e vlerës së tyre, si dhe rikthimin e asetëve dhe të ardhurave të krijuara prej tyre në dobi të shtetit dhe komunitetit.

Një prej treguesve kryesorë të këtij transformimi është rritja e të ardhurave nga qiradhënia e pasurive. Nga rreth 79 milionë lekë të ardhura të Agjencisë në vitin 2023, të ardhurat vetëm nga qiratë arritën rreth 160 milionë lekë në vitin 2024 dhe 221 milionë lekë në vitin 2025. Për periudhën janar–gusht 2026, nga qiratë janë siguruar rreth 180 milionë lekë, tha Xhaja.

Kryeadministratorja theksoi se të ardhurat e krijuara nga administrimi i pasurive nuk kanë vetëm një dimension financiar. Ato kalojnë në Fondin e Posaçëm, i cili përdoret për mbështetjen e institucioneve ligjzbatuese dhe strukturave që luftojnë krimin e organizuar, si dhe të organizatave që punojnë me kategoritë vulnerabël, viktimat e krimit, trafikimit dhe dhunës.

Një vëmendje e veçantë gjatë raportimit iu kushtua ripërdorimit social të pasurive të konfiskuara, në kuadër edhe të angazhimeve të Shqipërisë në procesin e integrimit në Bashkimin Evropian. Objektivi është orientimi i të paktën 50% të pasurive të konfiskuara drejt ripërdorimit, përfshirë atë social.

Vetëm gjatë vitit 2026 janë destinuar për institucione 1.39 milionë euro dhe 21.5 milionë lekë, 11 pasuri të paluajtshme, 50 pasuri të luajtshme, 336 prova materiale dhe 491 armë për Policinë e Shtetit. Ndërkohë, për organizatat jofitimprurëse janë destinuar 150 mijë euro dhe tre pasuri të paluajtshme. Përmes një thirrjeje të Fondit të Posaçëm janë mbështetur 22 organizata që punojnë me viktimat e trafikimit, parandalimin e kriminalitetit dhe përdorimit të drogës, dhunën në familje dhe në shkolla, bullizmin dhe problematika të tjera sociale.

Në raportim u bë e ditur se AAPSK ka aktualisht në administrim 2,665 pasuri të sekuestruara, me vlerë rreth 28.5 miliardë lekë, 516 pasuri të konfiskuara, me vlerë rreth 6.8 miliardë lekë, si dhe 774 prova materiale, me vlerë rreth 1.2 miliardë lekë. Vetëm gjatë

TE FUNDIT

Apeli pranon kërkesën e Metës: Do të qëndrojë jashtë kafazit të xhamit në sallën e gjyqit

⌚ Mbeti me dy nxënës, një tjetër shkollë e mbyllur në Qarkun e Korçës

⌚ Pushteti Vendor halllka e dobët, 20 incidente kibernetike në 6 muaj, 4 kritike me prekje të dhënash

⌚ Nis viti i ri shkollor, mbi 300 mijë nxënës rikthehen në klasa, 25 mijë ulen për herë të parë

MË TË VIZITUARAT

Shpëtojnë për mrekulli zyrtarët europianë, droni rus godet trenin pranë kufir...

Protestë dhe alarm për bombë, priset qetësia në ditën e parë të shkollës, po...

Bie sërisht Euro, prek minimumin e ri historik

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

vitit 2026 janë kryer 1,175 sekuestime pasurish, 84 konfiskime dhe 181 revokime. Rritja e volumit të pasurive në administrim lidhet edhe me intensifikimin e veprimtarisë së institucioneve ligjzbatuese dhe rezultatet e SPAK-ut në identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive me origjinë kriminale.

Kryeadministratorja u ndal gjithashtu te forcimi i bashkëpunimit me prokuroritë, gjykatat, Policinë e Shtetit, BKH-në dhe strukturat e tjera ligjzbatuese, i cili ka ndihmuar në shkurtimin e kohës së ekzekutimit të vendimeve dhe marrjen më të shpejtë në administrim të pasurive të sekuestruara apo të konfiskuara.

Një tjetër drejtim i rëndësishëm është bashkëpunimi ndërkombëtar. AAPSK ka intensifikuar marrëdhëniet me institucionet homologe në Itali, Francë, Mbretërinë e Bashkuar, Spanjë dhe vende të rajonit. Në këtë kuadër u veçua marrëveshja me autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar, e cila përbën rastin e parë në Shqipëri të një International Asset Sharing Agreement, ku të ardhurat nga shitja e një pasurie të lidhur me një shtetas shqiptar të dënuar në Mbretërinë e Bashkuar ndahen mes dy shteteve.

Në kuadër të integritimit evropian, AAPSK po punon edhe për forcimin e kapaciteteve për administrimin e aseteve virtuale dhe kriptomonedhave, një prej çështjeve të evidentuara nga Komisioni Evropian. Agjencia ka investuar në trajnimin e stafit, përshtatjen e kuadrit ligjor dhe ngritjen e kapaciteteve teknike dhe institucionale për ruajtjen, administrimin dhe destinimin e këtyre aseteve në rast sekuestrimi apo konfiskimi.

Për periudhën 2025–2030, ndër prioritetet strategjike të AAPSK-së janë krijimi i një sistemi të përbashkët ndërinstitucional për ekzekutimin e vendimeve dhe menaxhimin e pasurive, digjitalizimi i plotë i arkivës, përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor dhe rritja e ripërdorimit social të pasurive të konfiskuara.

Në përfundim të raportimit u theksua se objektivi i AAPSK-së është kalimi nga një institucion që thjesht merr dhe mban pasuri në administrim, në një institucion që i administron ato në mënyrë aktive, transparente dhe produktive, duke ia rikthyer vlerën e tyre shtetit dhe shoqërisë. **(A2 Televizion)**

A2 CNN Livestream

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Goditi me grusht protestuesin, pezullohet nga detyra inspektori i policisë



Kapen mbi 41 kg kokainë në Portin e Durrësit, 2 milionë euro vlera në treg





Plagosi me drapër babanë e ish-bashkëjetueses, arrestohet autori



Elbasan, 18-vjeçari e përplas me makinë, humb jetën i moshuarin




Procedohen 20 protestues, Policia: Blllokuan rrugët e Tiranës dhe prishën qetësinë publike



Kishin humbur rrugën pas malit të Dajtit, Policia iu shkon në ndihmë 2 turistëve gjermanë

Latest Videos



Hetoi Shtëpinë e Verdhë, ish-prokurori i habitur nga Haga: Përdorën si prova raporte nga Serbia



Akuzat ndaj UÇK-së? Flet ish-prokurori: Të ngritura me prova të rreme



Pushteti Vendor halllka e dobët, 20 incidente kibernetike në 6 muaj, 4 kritike me prekje të dhënash



Protestuesit përplasen me policinë te Zogu i Zi, alarm fals për bombë në shkollë-PULS-Bruna Çifligu

Shqipëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi
Sociale
Kulturë
Moti

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë
Kronikë
Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim

Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë
Lumi i kokainës
Ditari ndërkombëtar
Zbulio
Imagjinatë
Dëshmi



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.